

Date: 09. 03. 2016

Qëndrim i organizatave mjedisore në Tiranë mbi vendimmarrjen në zhvillimet e projektit për ndërtimin e një këndi lojërash në “Parkun e Madh të Tiranës”

I nderuar Z. Erion Veliaj,

nëpërmjet kësaj letre Ju adresojmë publikisht qëndrimin e organizatave mjedisore në Tiranë, mbi vendimmarrjen dhe ngjarjet kronike në Parkun e Madh të Tiranës. Nga afër dhe nga larg, kemi ndjekur me vëmendje prezantimin e projektit të këndit të lojërave dhe tre mbrojtjet në debatet publike që Bashkia Tiranë është detyruar të mbajë. Me keqardhje kemi ndjerë përplasjet dhe dhunën midis qytetarëve dhe forcave të policisë. Kësisoj, qëndrimi ynë Ju paraqitet si një analizë më e gjerë e vendimmarrjes vendore.

Duke monitoruar punën dhe deklaratat Tuaja për projektin konkret, fillimisht Ju sjellim në vëmendje disa shtylla të rëndësishme të mirëqeverisjes vendore dhe vendimmarrjes mjedisore (por jo vetëm) në një shoqëri demokratike:

- a. **Votat që banorët e Tiranës ju besuan më 21 qershor 2015, nuk mund të konsiderohen apriori vota miratimi për të gjitha projekt idetë e prezantuara në fushatën tuaj elektorale!** Shqipëria është një vend demokratik. Ne kemi transpozuar, ndër të tjera, gati të plotë të gjithë Direktivat e Bashkimit Evropian për Legjislacionin Horizontal, i cili specifikisht forcon rolin e publikut në vendimmarrjen mjedisore, dhe zbaton parimet e mbrojtjes së mjedisit me fokus kryesor zhvillimin e qëndrueshëm. Gjithashtu, prej vitit 1998 jemi vend firmëtar i Konventës së Aarhus – it dhe në vitin 2000 e kemi ratifikuar këtë Konventë.

- b. Në demokraci shumica vendos, por pakica respektohet! Arroganca nuk Ju nderon Z. Kryebashkiak! Për projektin e këndit të lojërave, Bashkia Tiranë ka dështuar të argumentojë publikisht akuzat për vendimmarrjen e saj jo transparente, akuza të cilat tregojnë se vendimmarrja Juaj ka cënuar demokracinë dhe shfaqet si një model i dobët qeverisjeje. Të gabosh është njerëzore, dhe në procesin e vendimmarrjes për projektin në fjalë Bashkia Tiranë ka gabuar¹. **Në këto kushte, është dinjitoze dhe e pranueshme të kërkohet falje publike dhe**

Midis shumë akteve të tjera listojmë se në vendimmarrjen konkrete mjedisore keni anashkaluar të paktën:

1. Nenet 23, 48 dhe 56 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
2. Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”
3. Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”
4. Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”
5. Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit” (Konventa e Aarhus-it).
6. Ligji nr.10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”

Bashkia të rinisë nga e para procedurat e duhura dhe transparente për propozimin e këtij projekti.

- c. Shoqëria civile përfaqëson grupe shumë më të gjera sesa vetëm OJF-të, por në të njëjtën kohë përfaqëson edhe një individ të vetëm. **Ju duhet të përmirësoni kanalet e komunikimit dhe transparencën me qytetarët, të cilëve u detyroheni llogaridhënie.** *Më konkretisht po ju sjellim disa raste:* Faqja Web e Bashkisë Tiranë, në kohën kur flasim për “Green dhe Smart Cities”, është një faqe hermetike. Nëpërmjet saj, nuk marrim informacion mbi aktivitetet e radhës apo konsultat për dokumenta dhe projekte të rëndësishme vendore. Ftesat shpesh janë kryer me telefonata, tek një grup i vogël njerëzish, pak minuta përpara zhvillimit të procesit, të cilat më pas reklamohen si konsultime të suksesshme. Duke shtuar që diskutimet e këtyre takimeve, pavarësisht si realizohen, nuk janë publike. Kjo do të thotë që qytetarët e interesuar nuk informohen për çështjet që janë diskutuar në takim dhe në çfarë mase janë përfshirë rekomandimet e të pranishmëve, në vendimin përfundimtar mbi projektet vendore.
- d. Është zhgënjyese tek ju shikojmë vazhdimisht të mbillni e numëroni filiza drurësh në Parkun e Madh. Besojmë se sektorët dhe agjencitë pranë Bashkisë mund të kujdesen me përgjegjshmëri për këtë pjesë, dhe në mënyrë të vazhdueshme. **Ne kemi pritshmëri të larta për qeverisjen Tuaj vendore.** Duam të diskutojmë plane dhe strategji vendore transparente dhe gjithëpërfshirëse, të cilat zhvillojnë qytetin në mënyrë të qëndrueshme, çka përkthehet që integrojnë mbrojtjen e mjedisit në çdo shërbim vendor në bashkëpunim të ngushtë me qytetarin.
- e. Është njësoj zhgënjyese tek dëgjojmë “ofertën transparente” për monitorimin e punës Tuaj dhe matrikullimin e çdo pemë në Park. Z. Kryebashkiak, legjislacioni shqiptar i jep çdo qytetari të drejtën të jetë monitorues, i informuar, dhe të ketë zë në vendimmarrje, në çdo projekt që hartohet dhe zbatohet në zonën e tij të banimit. Qytetarët e Tiranës e bëjnë shumë mirë këtë rol, ndaj sot Bashkia është e detyruar të japë llogari për projektin e këndit të lojërave. **Mirëpresim oferta më të merituar në një frymë bashkëpunuese!**
- f. **Falenderoni qytetarët tuaj!** Është emocionuese të shikosh atë grup të vogël qytetarësh tek mbrojnë interesin publik me çdo kusht. Organizatat mjedisore në 20 vite kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë që qytetarët e Shqipërisë të jenë kështu të përfshirë dhe aktivë! Ata janë

7. Vendim nr.16, datë 4.1.2012 “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor”

8. Vendim i KM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”

Duke shtuar që “mendimet kundëra” projektit për këndin e lojërave në Parkun e Liqenit nuk po i menaxhoni duke përdorur si mjet dialogun me qytetarët, por nëpërmjet deklarateve të largëta mediatike dhe duke nxitur dhunë

organizuar pa mbështetje të OJF-ve, pa argumenta të fortë të strukturuar (edhe pse kanë mbështetjen mediatike të shumë penave të forta), dhe mbrojnë identitetin e tyre si një grup jo i politizuar. Falenderojini ata për oponencën që ju japin dhe që përmbushin detyrën si qytetarë, dhe bindini me shumë punë që Ju dhe ata keni të njëjtin qëllim!

Është e trishtueshme tek ju dëgjojmë ti drejtoheni atyre me fjalë fyese, ti etiketoni si “grup vandalësh” meqenëse janë pak në numër dhe tek i vini përballë forcave të rendit duke nxitur përleshje dhune. Është akoma më shkurajuese kjo vendimmarrje kur ne Ju referojmë si një figurë që vjen nga shoqëria civile, i cili ka luftuar për demokracinë, e mbron dhe e beson atë.

Në këtë kornizë, ne vijojmë dhe **ju kërkujmë**:

1. **Bëni publik planin zhvillimor për zonën “Parku i Madh i Tiranës”,** të cilin Bashkia Tiranë e ka referuar në disa dalje publike duke e cilësuar si projekti për jetësimin e Parkut! Ju informojmë që ky plan është subjekt i nënshtrimit të procedurave të Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Në këtë mënyrë qytetarët nuk do luftojnë me “gogolin” (sikundër ju shpreheni).
2. **Prej këtij plani, zhvilloni në detaje projektin e këndit të lojërave dhe bëjeni atë publik si një dokument zyrtar!** Sërish qytetarët nuk do luftojnë me “gogolin” (sikundër ju shpreheni).
3. Si rrjedhojë, **Pezulloni punimet për zbatimin e projektit të këndit të lojërave** deri në informimin dhe përfshirjen e duhur të publikut duke ndjekur procedurat ligjore të një shteti demokratik.
4. **Përmirësoni kanalet, infrastrukturën dhe frymën e komunikimit me qytetarët, duke i përfshirë ata realisht në vendimmarrjen mjedisore!**

Me besim,

nisin këtë qëndrim organizatat mjedisore në Tiranë²si më poshtë

1. Albanian Ornithologists Association (AOS)
2. Albanian Society for the Protection of Birds and Mammals(ASPBM)
3. Biologist of Albania

² Dëshirojmë të theksojmë se jemi një grup organizatash jo qeveritare, jo politike që punojnë prej vitesh në Shqipëri për mbrojtjen e mjedisit dhe kemi eksperiencën të shumta bashkëpunimi me pushtetet vendore për ngritjen e modeleve të mirëqeverisjes vendore, kryesisht në vendimmarrjen mjedisore. **Nuk jemi një grup politik, por nuk do na vinte keq nëse të gjithë politikanët do të besonin në frymën tonë, atë të mbrojtjes së mjedisit dhe qeverisjes demokratike**

4. EcoAlbania
5. Iliria
6. GO2
7. Institute for Environmental Policy (IEP)
8. Milieukontakt Albania
9. Environmental Center for Development, Education and Networking (EDEN)
10. Organic Agriculture Association

Për dijeni:

1. Z. Bledar Çuçi, Ministër, Ministria e Shtetit për Çështjet Vendore
2. Z. Aldrin Dalipi, Kryetar, Këshilli Bashkiak Tiranë
3. Z. Igli Totozani, Avokati i Popullit
4. Z. Lefter Koka, Ministër, Ministria e Mjedisit
5. Z. Besnik Dervishi, Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.